



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mamushës (KM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mamushës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mamushës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mamushës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mamushës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mamushës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në mos regjistrimin e pasurive, pastaj procesi i inventarizimit nuk ishte harmonizuar me PFV, mungesa e funksionimit të sistemit e-pasuria dhe mosregjistrimi i pasurive nën 1,000€, të cilat janë paraqitur më poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Raporti i auditimit ka rezultuar me një (1) rekomandim të ri dhe dy (2) rekomandime të përsëritura. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e parqitur në PFV e pasurive kapitale është 7,638,999€, pasurive jokapitale është 40,045€, si dhe e stoqeve 67,460€.

#### Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale

**Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6 paragrafi 3, përcakton se; pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Komuna nuk e kishte evidentuar në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ (SIMFK) një kompjuter me vlerë 1,480€, ndonëse tejkalohte pragun e përcaktuar për regjistrim.

Shkaku i mos regjistrimit të pasurive në sistemin e-pasuria ishte mungesa e komunikimit të ndërsjellët në mes detyrave të caktuara të zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurive të blera në regjistrat kontabël përveç që pamundësojnë menaxhimin e duhur të pasurisë, ato shkaktojnë mungesë të informatave për pasurinë që ka në dispozicion komuna, nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare.

**Rekomandimi B1** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€, të cilat përmbushin kriteret për kapitalizim, të regjistrohen në regjistrin e pasurive në mënyrë të saktë dhe në kohë. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme në procesin e pranimit dhe regjistrimit të pasurive, në mënyrë që të parandalohet mosregjistrimi i pasurive të ngjashme në të ardhmen.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Mos funksionimi i sistemit e-pasuria dhe mosregjistrimi i pasurive

**Gjetja** Reegullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6 paragrafi 3 përcakton se; pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet, në sistemin e-pasuria.

Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se 2 (dy) pagesa në vlerë totale prej 9,500€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria, edhe pse secila pasuri ishte nën vlerën 1,000€.

- Pagesa e parë, përfshinte pasuri në vlerë 8,032€ të cilat nuk ishin regjistruar si në vijim: 15 kompjuterë model desktop, secili në vlerë 438€ dhe 15 monitor model 1, secili në vlerë 97.5€.
- Pagesa e dytë në vlerën totale prej 1,468€, ishte furnizim me vegla pune dhe paisje tjera për mirëmbajtje të hapsirave publike.

Komuna edhe gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur që të regjistroj të gjitha pasuritë me vlerë nën 1,000€ në sistemin e-pasuria. Megjithatë komuna ka bërë regjistrimin e pasurisë jokapitale në një regjistër të brendshëm për menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe pasuritë regjistrohen në këtë regjistër.

Shkaku i mos regjistrimit të pasurive në sistemin e-pasuria ishte mungesa e komunikimit të ndërsjellët në mes detyrave të caktuara të zyrtarëve përgjegjës.

#### **Ndikimi**

Mosregjistrimi i të gjitha pasurive në sistemin e e-pasurisë ndikon negativisht në përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe shkakton mungesë të informatave të sakta për menaxhmentin lidhur me pasuritë që komuna ka në dispozicion. Kjo situatë mund të çojë në mbi-apo nënvlerësim të pasurive, si dhe në paraqitje të pasaktë dhe jo të plotë të informatave në pasqyrat financiare vjetore (PFV).

#### **Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e e-Pasurisë dhe të sigurohet që të gjitha pasuritë e komunës janë të regjistruara në këtë sistem. Po ashtu, vlera e pasurive nën 1,000€ duhet të prezantohet në pasqyrat financiare vjetore (PFV) sipas vlerës kontabël neto, në mënyrë që paraqitja e tyre të jetë e plotë dhe e saktë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

##### **Çështja A1 - Dobësi në harmonizimin e inventarizimit dhe procedurat e menaxhimit të pasurisë**

#### **Gjetja**

Neni 19.4.3 të rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur.

Komuna kishte realizuar procesin e inventarizimit për pasuritë jo financiare, mirëpo nuk kishte kryer krahasimin dhe harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë që pasqyrohen në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV).

Këto mangësi janë rezultat i mosfunksionimit të duhur të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në fushën e menaxhimit të pasurisë.

#### **Ndikimi**

Moskrahasimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat zyrtarë mund të rezultojë në informata të pasakta në pasqyrat financiare, të rrisë rrezikun për menaxhim joefektiv apo keqpërdorim të pasurisë, si dhe të zvogëlojë besueshmërinë dhe transparencën në raportimin financiar.

#### **Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të shoqërohet me krahasim dhe harmonizim të plotë me regjistrat zyrtarë të pasurisë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezentuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>2,565,143</b>	<b>2,725,938</b>	<b>2,699,242</b>	<b>2,513,437</b>	<b>1,787,825</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	2,493,591	2,522,192	2,516,229	2,415,981	1,704,936
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	20,349
Të bartura nga viti i kaluar	0	44,604	27,904	49,780	32,009
Të hyrat vetanake	71,552	88,252	84,619	47,675	29,532
Donacionet vendore	0	750	750	0	1,000
Donacionet e jashtme	0	70,140	69,740	0	0

Buxheti final ishte rritur për 160,795€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake dhe të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe përfshirjes së donacioneve vendore dhe të jashtme.

Në vitin 2024, realizimi i shpenzimeve ishte rreth 99% e buxhetit final, me një rritje afër 7.4% krahasuar me vitin 2023.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>2,565,143</b>	<b>2,725,938</b>	<b>2,699,242</b>	<b>2,513,437</b>	<b>1,787,825</b>
Pagat dhe mëditjet	1,529,347	1,557,948	1,557,948	1,408,645	1,177,221
Mallrat dhe shërbimet	344,976	346,514	346,204	390,058	327,950
Komunalitë	24,000	31,359	31,359	34,000	30,955
Subvencionet dhe transferet	88,000	104,100	104,099	72,814	39,790
Investimet Kapitale	578,820	686,017	659,631	607,920	211,909

Shpenzimet kryesore janë realizuar në këto kategori:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 28,601€. Kjo kategori është realizuar 100% dhe përbën 57.7% të shpenzimeve totale. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet janë rritur për 149,303€ ose 10.6%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 1,538€. Shpenzimet janë realizuar në 99.9%, duke përbërë 12.8% të totalit të shpenzimeve. Krahasuar me vitin paraprak, ka një ulje prej 43,854€ ose 11.2%.
- Buxheti final për komunalitë është rritur për 7,359€. Realizimi ka qenë 100% dhe kjo kategori përbën 1.2% të totalit. Megjithatë, ka një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2023 për 2,641€ ose 7.7%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 16,100€. Shpenzimet janë realizuar pothuajse 100%, përbëjnë 3.86% të shpenzimeve dhe janë rritur me 31,285€ ose 43% krahasuar me vitin paraprak.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 107,197€, krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar 96.1% dhe përbëjnë 24.4% të totalit të shpenzimeve. Kjo kategori ka një rritje prej 51,711€ ose 8.5% në krahasim me vitin 2023.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2024 ishin në vlerë 83,058€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lëshimi i çertifikatave të lindjes, taksat për regjistrimin e automjeteve, participimet etj.

Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2023, ishin në nivel të njëjtë me një diferencë për vetëm 300€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>71,552</b>	<b>71,552</b>	<b>83,058</b>	<b>82,748</b>	<b>59,325</b>
Të hyrat tatimore	40,619	40,619	53,880	49,637	25,441
Të hyrat jo tatimore	30,933	30,933	29,179	33,112	33,884

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komunës së Mamushës (KM) ka identifikuar dy (2) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KM ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, dy (2) nga rekomandimet ende nuk janë adresuar. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria dhe të sigurojë se vlera e pasurisë nën 1,000€ në PFV prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për korigjim.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistroj të gjitha pasuritë kapitale në SIMFK, përfshirë edhe projektet si investime në vijim të cilat akoma nuk kanë përfunduar.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për korigjim.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe opinionin të pamodifikuar dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniq

Data: 16 Maj 2025



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.